

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



**PUNIMI I DIPLOMES – MASTER**

**SHPREHIT INDIVIDUALE TË JETESËS DHE AKTIVITETET  
REKREATIVE SPORTIVE**

**Mentori:**  
**Prof. Dr. Bujar Turjaka**

**Kandidatet:**  
**Merita Murseli**

**Lirijeta Gjuraj**

**Prishtinë, 2015**

# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>2. QËLLIMI I PUNIMIT .....</b>	<b>8</b>
<b>3. HIPOTEZAT THEMELORE .....</b>	<b>9</b>
<b>4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....</b>	<b>10</b>
4.1. <i>MOSTRA E ENTITETIT.....</i>	<i>10</i>
4.2. <i>MOSTRA E VARIABLAVE.....</i>	<i>11</i>
4.2.1 VARIABLAT E APLIKUARA .....	11
4.3. <i>METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE .....</i>	<i>13</i>
<b>5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI.....</b>	<b>14</b>
5.1. <i>DALLIMET BRENDA GRUPIT DHE NDERMJET GRUPEVE.....</i>	<i>14</i>
<b>5.1.1. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: MOSHA: 36 VJEÇ&gt;.....</b>	<b>14</b>
<b>5.1.2. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: MOSHA: 31-35 .....</b>	<b>20</b>
<b>5.1.3. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: MOSHA: 26-30 .....</b>	<b>27</b>
<b>5.1.4. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: MOSHA: 21-25 .....</b>	<b>34</b>
<b>5.1.5. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS MOSHA: 18-20 .....</b>	<b>41</b>
<b>5.1.6. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS – MESHKUJ .....</b>	<b>48</b>
<b>5.1.7. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS – FEMRAT .....</b>	<b>55</b>
5.2. <i>VËRTETIMI I HIPOTEZAVE .....</i>	<i>62</i>
<b>6. PËRFUNDIMI .....</b>	<b>64</b>
<b>7. LITERATURA .....</b>	<b>68</b>
<b>REZYME .....</b>	<b>70</b>
<b>SUMMARY.....</b>	<b>71</b>

## 1. HYRJJE

Aktiviteti fizik është i domosdoshëm për të pasur një shëndet të mirë fizik dhe mendor. Stili i jetesës është një integrim funksional dhe estetik i jetës që manifestohet në formën e marrëdhënieve njerëzore, sjelljeve, ndërgjegjes dhe mjedisit material. Njeriu modern shpesh përdor fjalën rekreacion, zakonisht për një aktivitet jo obligues që e argëton, e bënë të lumtur e relakson dhe e bënë të ndihet i hareshëm. Vetë koncepti ka kuptim kur është fjala për aktivitetet që nuk janë të imponuara dhe të cilat kanë një efekt pozitiv në shëndetin e njerëzve në aspektin mendor dhe fizik, në zhvillimin e kreativitetit, shoqërimin, arsimin dhe të ngjashme. Rekreacioni sportive si përmbajtje e ka veprimtarinë sportive, dhe përveç kënaqësisë, mund të ketë disa efekte pozitive në shëndetin e përgjithshëm të njeriut, e cila pasuron dhe fisnikëron botën në të cilën e jetojmë. Pushime aktive në kohën e lirë, në fakt, angazhimi në një sport, është një nevojë gjithnjë e më e rëndësishme e njeriut modern. Vetëm përfshirja në aktivitete të ndryshme sportive, pa marr parasysh se bëhet fjalë për një shëtitje në pyll, kajak, kanu, ecje apo alpinizëm, mund të arrijë një përvojë të plotë dhe të kontaktoi me natyrën që atij aq mungon. Vetëm duke marrë pjesë në aktivitete të ndryshme sportive, njeriu i tjetërsuar modern mund të kompensojë nevojën për lëvizje, të lojë dhe të shoqërim, pasi ajo është shumë i nevojshëm .

Aktiviteti fizik si një nga komponentët thelbësore të një jetese të shëndetshme, përfaqëson të gjitha lëvizjet që rrisin harxhimin e energjisë, e cila është më e lart se sa ai harxhim i energjisë tek njerëzit që nuk zhvillojnë aktivitete fizike (pushojnë). Me këtë lloj aktiviteti kryesisht përfshihen aktivitetet e përditshme (ecjet në këmbë, çiklizëm, ngjitje shkallëve, punë në shtëpi, duke shkuar për të blerë, etj) . Ushtrimi, nga ana tjetër, është një aktivitet fizik i planifikuar dhe i qëllimshëm objektivi kryesor i të cilit është përmirësimi i shëndetit dhe kondicioni fizike. Format karakteristike të këtyre llojeve të aktiviteteve përfaqësojnë ecjet e shpejta, vrapimet me intensitete të ndryshme, format tjera natyrale të lëvizjeve, çiklizmi, gjimnastika ose aktivitetet profesionale. Ndryshe nga aktiviteti fizik dhe ushtrimet fizike, të cilat paraqesin procese të sjelljes, kondicioni fizik apo formë kondicionalë (fitnesi) paraqet ose përfaqëson shumë të attributeve që përcaktojnë kapacitetin për të kryer aktivitet fizik. Forma fizike është kryesisht e varur

nga niveli i aktivitetit fizik, dhe se programe të ndryshme të ushtrimeve mund të zbatohet me qëllim të përmirësimit e formës kondicional.

Të gjithë njerëzit kanë aftësi, mundësi dhe përvoja, dhe të gjithë janë të rëndësishme për shoqërinë. Prandaj, shoqëria duhet të jetë e dizajnuar në mënyrë që të gjithë mund të marrin pjesë në zhvillimin dhe në të arriturat e saj. Asnjë person nuk guxon të jetë i përjashtuar nga këto rregulla. Të gjithë duhet të jenë qytetarë me të drejta dhe detyrime të barabarta.

Hulumtimet kanë treguar se aktivitetet sportive dhe rekreacioni sportiv është një nga faktorët më efektiv për përshtatjen e njeriut në shoqëri, ndryshimeve mjedisore shoqërore, problemeve ekzistenciale të jetesës, etj. Vlerësimet e studimeve të gjertanishme tregojnë se rekreacioni dhe rekreacioni sportiv parandalon shumë sëmundje dhe rehabiliton shumë simptome psikologjike dhe lëndime traumatologjike, të tilla si depresionin, ankthin, tjetërsimin social, lëndimet në sporte të ndryshme etj, dhe për të zhvilluar një ndjenjë të sigurisë, aftësive, besimin, të komunikuarit e tjera.

Mund të themi se shprehia për çdo aktivitet sportiv profesional dhe rekreativ pa marr parasysh qëllimin e tij se a është parandalues apo shërues, fitohet në moshën e hershme të fëmijërisë. Për këtë në këtë moshë duhet ti kushtohet rëndësi e veçantë fitimit të shprehisë për aktivitete fizike, sportive dhe qëllime shëndetësore.

Nëse i shikojmë funksionet e aktiviteteve sportive rekreative, ato janë të shumta dhe të ndryshme, dhe i përcaktojnë një numër i faktorëve të ndryshëm. Sikur që aktiviteti rekreative veprimtari e lirë njerëzore në të cilën përmbajtja e punës paraqet dëshirat e pjesëmarrësve, ashtu edhe funksioni i aktivitetit rekreativ varet shumë nga nevojat dhe interesat e njerëzve të cilët merren me te. Nevojat më të shpeshta të njerëzve për aktivitetet rekreative janë nevojat për lëvizje, për të përmirësuar statusin e tyre shëndetësor, nevoja për argëtim, defrim, relaksim e tjera. Zhvillimi ekonomik i shoqërisë ka shkaktuar një ndryshim në gjendjen psiko-sociale, fizike, materiale dhe shëndetësore të individit. Niveli i gjendjes shëndetësore arsimore, lloji i punës, moshën kronologjike dhe mundësitë materiale janë vetëm disa nga faktorët që i orjentojnë njerëzit në sporte të

ndryshme dhe aktivitete rekreative. Pra, nevojat e ndryshme dhe aftësitë e njerëzve për ushtrime sportive dhe rekreative përcaktojnë funksionin apo qëllimin e cila arrihet me to

Aktivitetet rekreative dhe rekreacioni sportiv si një fenomen social ndikon në zhvillimin në shumë aspekte sociologjike dhe psikologjike. Përmbajtja sportive rekreative inkurajon zhvillimin e marrëdhënieve ndërpersonale, kolegjalitetit, shoqerueshmërin, respektimin e mendimeve e njerëzit të tjerë, punën në komunitete, etj. Përveç kësaj, aktiviteti rekreative sportive ndikon në mbrojtjen shëndetësore, socializimin, duke ruajtur ekuilibrin mendor, argëtues, zbatimjen, relaksim, etj.

Në përgjithësi, është e njohur se edhe më parë se aktiviteti rekreativ është përdorur për parandalimin dhe rehabilitimin e sëmundjes. Në kohën e tashme janë zhdukur shprehitë e njerëzve për ushtrime fizike dhe aktivitete rekreative, por edhe mënyra e jetes dhe punës aktive është reduktuar në minimum. E gjithë kjo shkaktoi një rënie në funksionin e organeve dhe sistemeve të organeve, duke çuar në sëmundjen e re të quajtur pasivitet në lëvizje ose moslëvizje. Me këtë lloj aktiviteti nënkuptojmë aktivitetin e përditshëm.

Në të shumtën, aktiviteti rekreativ si mjet për realizimin e qëllimit përdor ecjen. Ecja si element më i rëndësishëm i lëvizjeve kryesore është e domosdoshme për jetën e përditshëm. Përveç rëndësisë edukative ajo ndihmon zhvillimin e përgjithshëm të organizmit. Ecja te nxënësit duhet të jet e lire (pa shtrengim të muskujve), elastike, duke vënë shputat paralel dhe me trup të drejt. Hedhja e këmbëve anash është mënyrë e gabuar e ecjes e cila e zvogëlon efikasitetin e gjatësisë të hapit, prandaj duhet sa më shpejt të mënjanohet gabimi në fazë kur ende nuk ka kaluar në shprehë. Gjatësija normale e hapit është 70-80cm, gjatësitë mbi ose nën këta vlera përbëjnë hapin e gjatë ose të shkurtër. Për ecje me hap të shpejtësuar themi atëherë kur ai bëhet mbi 120 hapa në minutë, ecje e ngadalshme përbëhet me më pak se 70 hapa në minutë. Ecja hyn në grupin e lëvizjeve ciklike i përbërë nga kombinimi i hapit të majtë me atë të djathtë. Struktura e ciklit të plot përfshin: Pjesa e parë e ciklit është e përbërë prej shtytjes të njënjës këmbë në pozicion prapa e cila e shkarkuar nga pesha e trupit kalon në luhatje para dhe mbaron me vendosjen e themrës para në tokë ashtu që në këtë pozicion pesha e trupit është e shpërndarë në të dy këmbët (njëra e mbështetur në tokë në pozicion para ndërsa tjetra

gjendet në pozicion të mbështetjes prapa). Pjesën e dytë të ciklit e përbën tjetra këmbë e cila prej mbështetjes para duke bartë tërë peshën e trupit kalon në fazë të mbështetjes vertikale dhe pjesën e dytë të ciklit e mbaronë me shtytjen e këmbës që gjendet në pozicion të mbështetjes prapa. Mbajtja e drejtëpeshimit ndihmohet nga lëvizjet e krahëve ashtu që këmba e djathtë bashkërendohet me krahun e majtë. Lëvizjet e krahëve në kyçet e supit dhe të bërylit harmonizohen me lëvizjet e këmbëve. Në strukturën e ecjes mund të vërehet se njëra këmbë vazhdimisht ka mbështetje me tokën. Në ecjet sportive garuesi diskualifikohet në qoftë se gjatë ecjes paraqitet fazë fluturuese. Duke filluar prej moshës parashkollore, fëmijët duhet të mesojnë ecjen e zakonshme me ruajtjen dhe ndrimin e ritmit të hapave. Në çdo orë të mësimin ecjeve duhet kushtuar vëmendje të posaçme me qëllim që të formohen shprehitë:

- koka e trupi të mbahen drejt, shpatullat të zhvendosura prapa, barku i futur dhe me shikim 3-4 m para, si kusht për të zghedhur rugën e ecjes.

- Ecja të jetë e harmonizuar me mbështetje optimale të shputës në drejtim para pa ngritjen e këmbëve shumë lartë si dhe këmbët mos tërhiqen zvarrë.

- Të bashkërendohen lëvizjet e këmbëve me krahët gjatë ecjeve me intenzitet të ndryshëm.

- Për formimin e shprehive të ecurit duhet përdorur orientues pamorë (katrorë të vizatuar në tokë) të cilët përgjigjen gjatësisë mesatare të hapit.

Për fëmijët e moshave të reja, ecja duhet të jetë e sigurtë dhe në çdo aktivitet rekreativ të përsoset me elemente të reja. Rëndësi të posaçme kanë ecjet figurative (gjarpërore, në rreth, zig-zagë, tetëshe, në vargë e tj.).

Përveç ecjeve të zakonshme, personat që bëjnë rekreacion mund të përdorin edhe këto mënyra të ecjeve: në maje të gishtrinjëve, e puthitur, në thembërra, ecje në anën e brendëshme e të jashtme të shputës, me kryqëzim hapash, hapa gjimnastikore, me ngritjen e gjunjëve lart e tj. Mënyrat e lartëpërmendur të ecjeve kanë për qëllim të forcojnë muskujt e këmbëve, kyçet (sidomos të kaviles) dhe ligamentet. Varësisht prej moshës, ecjet te moshat shumë të reja aplikohen në distanca të shkurtëra dhe pushime të

shpeshta, për dallim prej atyre që kanë moshë më të madhe të cilët mund pak ma gjatë të ecin. Duhet theksuar se deri te cikli i ulët i shkollimit, elementet e ecjeve të lartëpërmendur nuk preferohen për gara shkaku se egziston mundësija për lëndimin e kyçit të kaviles. Fëmijët e kësaj moshe duhet të aftësohen të ecin nëpër shtresa të ndryshme, sidomos preferohet ecja këmbëzbathur në sipërfaqe me rërë e cila ndihmon zhvillimin e zakonshëm të shputave. Ecjet në sipërfaqe të fortë (asfalt ose beton), shkaktonë lodhje dhe në distanca më të gjata lëndime në strukturën e shputave të njomë. Që të mbahet niveli i lartë i vëmendjes, ecjet duhet të aplikohen duke kaluar pranë rekuizitave të vendosur në formë të pengesave (topa, rrathët, shishet e drurit, kubet etj) me tempo dhe mënyrë të ndryshme. Ecja nëpër sipërfaqe të kufizuara (tra ose vija të vizatuara), ndihmon në zhvillimin e bashkërendimit dhe symatjen e personave të të gjitha moshave.

## 2. QËLLIMI I PUNIMIT

Ndjenja e koherencës tregon se siguria e individit për botën në të cilën ai jeton e kuptueshme, e përballueshme dhe kuptimplote.

Problemi hulumtimi është të shqyrtojë nëse ato ndryshojnë në aspektin e ndjenjave të koherencës dhe orientimit ndërpersonal të njerëzve të cilët angazhohen në aktivitetet sportive dhe rekreative në krahasim me ata të cilët nuk janë të përfshirë në aktivitetet sportive dhe rekreative.

Qëllimi i hulumtimit ka rëndësinë teorike dhe praktike. Qëllimi teorik i hulumtimit është të tregojë se personat të cilët janë të angazhuar në rekreacionin sportiv kanë të zhvilluar ndjenjën e koherencës dhe orientimit ndërpersonal më tepër sesa ata të cilët nuk janë të përfshirë në sport dhe rekreacionin sportiv si dhe fitojnë shprehje të jetesës në drejtim të përmirësimit të shëndetit . Qëllimi praktik i hulumtimit është që në bazë të rezultatit të hulumtimit të inkurajohen më shumë popullatën për angazhim më të madh në aktivitetet rekreative sportive.

Hulumtimi i cili do të realizohet në kuadër të këtij projekti hulumtues pranë këtij Fakulteti të Prishtinës, si hulumtim transferzal, ka për qëllim, para se gjithash, identifikimin e disa shprehjeve të jetesës të popullatës së Prishtinës të cilat mund të kenë ndikim në përcaktimin e mbështetjes së aktiviteteve rekreative sportive në qytetin e Prishtinës.



### 3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëmisë dhe problemit të hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve formulohen dhe parashtrohen këto hipoteza:

**H<sub>01</sub>** – Presim të fitohen dallime të rëndësishme në mes frekvencionit të vërejtur dhe atij teorik brenda grupit në të gjitha pyetjet e pyetësorëve të aplikuar në këtë hulumtim.

**H<sub>02</sub>** – Presim të fitohen dallime të rëndësishme në mes frekvencionit të vërejtur dhe atij teorik në mes grupeve në të gjitha pyetjet e pyetësorëve të aplikuar në këtë hulumtim.

## **4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

### **4.1. MOSTRA E ENTITETIT**

Rëndësia e hulumtimit është e lidhur numrin e mostrës. Zgjedhja e mostrës ka qenë, para së gjithash, e kushtëzuar me mundësit organizative të matjes. Tek hulumtimet e këtij lloji është e rëndësishme, domethënë, sigurimi i ekipit të nevojshëm që kanë përvojë me këso lloje të anketimeve. Popullata nga e cila është nxjerrur mostra e entitetit është definuar si popullatë e personave nga komuna e Prishtinës. Me metoden e mostrës së rastësishme është përzgjedhur mostra e të anketuarve për qëllimet e këtij hulumtimi. Në hulumtim janë përfshirë – gjithsejt 500 të anketuar të ndarë në dy gjini dhe në 5 grupe.

Pra, 250 të anketuar të gjinisë mashkullore dhe 250 të anketuar të gjinisë femrore. Mostra e të anketuarve në aspektin e kategorive të moshës është ndarë në pesë nëngrupe. Grupin e të moshuarave prej 18-20 vjeçare e përbëjnë nga 50 të anketuar nga dy gjinitë. Grupin e të moshuarave prej 21-25 vjeçare e përbëjnë nga 50 të anketuar nga dy gjinitë. Grupin e të moshuarave prej 26-30 vjeçare e përbëjnë nga 50 të anketuar nga dy gjinitë. Grupin e të moshuarave prej 31-35 vjeçare e përbëjnë nga 50 të anketuar nga dy gjinitë. Grupin e të moshuarave mbi 35 - > vjeçare e përbëjnë nga 50 të anketuar nga dy gjinitë.

## 4.2. MOSTRA E VARIABLAVE

Si instrument i hulumtimit do të përdoret pyetësi, posaçërisht i konstruktuar për këtë hulumtim. Në pjesën ku ka të bëjë në vlerësimin e shprehive të jetesës të anketuarave si indikator ose tregues kryesor janë të dhëna përshkrimet aktiviteteve të mëposhtme të cilat konsiderohen si shprehi të jetesës: Pirja e cigareve, konsumimi i alkoolit, ushqimi i rregullt, gjumi i rregullt dhe marrja me aktivitete rekreative sportive.

### 4.2.1 Variablat e aplikuara

Pyetësi ka përfshirë këto pyetje:

I - merrem me aktivitete rekreative sportive:

1. rregullisht (së paku 3 here në javë)
2. kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)
3. asnjë herë

II - mendimi i të anketuarave mbi shfrytëzimin e sportit në qytet : Pyetja-organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë e dobishme:

1. po
2. nuk jam e sigurt
3. jo

III – Qëndrimi i të anketuarave mbi pjesëmarrjen aktive në aktivitetet rekreative sportive. A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive:

1. po
2. ndoshta
3. jo

IV – Frekuenca e konsumimit të cigareve. Sa cigare koonsumoni në ditë:

1. deri 10 cigare
2. 10-20 cigare
3. ma teper se 20 cigare në ditë
4. nuk e konsumoj.

V – Konsumimi i alkoholit. A konsumoni alkoholin:

1. rregullisht (çdo ditë
2. kohë pas kohe (nganjëherë në javë
3. nuk e konsumoj.

VI – Shprehit në ushqim në shujta. Sa shujta në ditë i hani.

1. 1 here ne ditë
2. 2 here në ditë
3. 3 here në ditë
4. 4 here në ditë

VII – Orari i gjumit. Sa orë gjumë bëni:

1. 5 orë
2. 6 orë
3. 7 orë
4. 8 orë
5. 9 orë
6. 10 orë

### 4.3. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Metodat e përpunimit të rezultateve kryesisht aplikohen në harmoni me qëllimin e hulumtimit, hipotezat e parashtruara si dhe me numrin e pjesëmarrësve në hulumtim.

Në mënyrë që kërkimi shkencor që të jep zgjidhje të kënaqshme, janë përdorur procedurat e duhura që janë të natyrës së atij problemi të dhënë.

Nga hapësira statistikore komparative (krahasuese) për dy grupe e pavarura të mostra është përdorur procedura diskriminative, para se gjithash, analiza parashikuese ( $\chi^2$ -Hi-katror testi) i cili aplikohet për të shqyrtuar dallimin në mes të frekuencave të vërejtura dhe pritura ose teorike brenda grupit dhe në mes grupeve dhe gjinive.

T-test mund të llogaritet vetëm atëherë nëse të dhënat ose shënimet janë të renditura në bazë të shpërndarjes normale ose të paktën sipas një shpërndarje simetrike, ndërsa  $\chi^2$ -Hi-katror testi, mund ta aplikojmë edhe në qoftë se shpërndarja (distribucioni) i rezultateve në mënyrë të konsiderueshme është e ndryshme nga normalja. Pra, kur nuk mund ta përdorim të ashtu-quajturën, statistikën parametrike, e cila kërkon një shpërndarje (distribucion) normal dhe të dhëna sasiore (shënime kuantitative), përdoret  $\chi^2$ -Hi-katror testi i cili i takon të ashtuquajturës. statistika joparametrike.

## 5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI

### 5.1. DALLIMET BRENDA GRUPIT DHE NDERMJET GRUPEVE

Hulumtimi ka qenë i kushtëzuar nga numri i të anketuarëve si dhe nga gjinia e të anketuarve, kryesisht në aktivitete rekreative sportive.

#### 5.1.1. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: Moshë: 36 vjeç>

*Tabela 1. PyetëSORI: “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.*

Merrem me aktivitete rekreative sportive	36> M	36> F	Σ
regullisht (së paku 3 here në javë)	4	17	21
Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	39	20	59
Asnjë here	7	13	20
Σ	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2= 45.160$ df: 2 P= 0.000	$\chi^2= 1.480$ df: 2 p= 0.477	$\chi^2=15.966$ df: 2 P= 0.00

Në çdo shtet bëhen programe rreth zhvillimit të fushave të caktuara të atij shteti, pra edhe të sportit si veprimtari shoqërore që është e orientuar në ngritjen e nivelit shëndetësor të popullatës si dhe e tregon zhvillimin ekonomik, arsimor, të legjislatues e tjera të një shteti. Në pyetjen e të anketuarëve “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, 78% nga të anketuarëve merren kohë pas kohe (kryesisht vikendeve), çka ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që merren rregullisht dhe atyre që nuk merren asnjëherë. Në pyetjen e të anketuarave “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, në mes të anketuarave nuk ekziston një dallim i rëndësishëm. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje ( $\chi^2=15.966$ ;  $P<0.000$ ) (tabela 1).

**Tabela 2. Pyetësori: “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.**

II Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme:	36> M	36> F	∑
Po	10	21	31
Nuk jamë i sigurt	38	13	51
Jo	2	16	18
∑	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2= 42.880$ df: 2 P= 0.000	$\chi^2= 1.960$ df: 2 p= 0.375	$\chi^2=27.047$ df: 2 P= 0.000

Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në çdo qytet të Kosovës do të ishte i dobishëm në ruajtjen dhe avansimin e shëndetit për popullatën e e të gjitha moshave dhe gjinive, sidomos e asaj mbi moshën 36 vjeçare. Në pyetjen e të anketuarëve “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme”, 38 të anketuar ose 76% nga të anketuarëve përgjigjen se “Nuk jamë i sigurt”, çka ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që mendojnë se: Po – do të jetë i dobishëm dhe atyre që janë përgjigjur “Nuk jamë i sigurt”. Te femrat nuk ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit në pyetjen: “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme”. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje ( $\chi^2=27.047$ ;  $P<0.000$ ) (tabela 2).

Brengos fakti se të anketuarit e gjinisë mashkullore dhe femrore nuk kanë njohuri mbi rëndësin e organizimit të aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë. Kjo edhe reflektohet me psesëmarrje shumë të vogël të popullatës së Prishtinës në aktivitete rekreative sportive.

**Tabela 3. Pyetësi: “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.**

III. Qëndrimi i të anketuarave mbi pjesëmarrjen aktive në aktivitetet rekreative sportive: A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive:	36> M	36> F	Σ
Po	6	17	23
Nuk jamë i sigurt	34	21	55
Jo	10	12	22
Σ	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2=27.520$ df: 2 P= 0.000	$\chi^2= 2.440$ df: 2 p= 0.295	$\chi^2=8.515$ df: 2 P= 0.014

Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në çdo qytet të Kosovës do të ishte i dobishëm në ruajtjen dhe avansimin e shëndetit për popullatën e të gjitha moshave dhe gjinive, sidomos e asaj mbi moshën 36 vjeçare. Në pyetjen e të anketuarëve “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”, 34 të anketuar ose 68% nga të anketuarëve përgjigjen se “Nuk jamë i sigurt”, çka ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që mendojnë se: Po – marr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive, atyre që mendojnë “Nuk jamë i sigurt” dhe atyre me përgjigje “Jo”. Te femrat nuk ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit në pyetjen: “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje ( $\chi^2=8.515$ ;  $P<0.014$ ) (tabela 3).

Të anketuarit e gjinisë mashkullore dhe femrore nuk merrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive. Kjo edhe reflektohet me pjesëmarrje shumë të vogël të popullatës së Prishtinës në aktivitete rekreative sportive.



**Tabela 4. Pyetësi: “Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.**

IV. Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor	36> M	36> F	$\Sigma$
10-20 cigare	9	10	19
ma teper se 20 cigare në ditë	19	8	27
nuk e konsumoj	22	32	54
$\Sigma$	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2=5.560$ df: 2 P= 0.062	$\chi^2=21.280$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2=6.386$ df: 2 P= 0.041

Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor i duhanit do të ishte i damshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive. Në pyetjen e të anketuarëve “Konsumimi ditor i cigareve”, të anketuarit e kësaj moshe kanë përgjigje gati të njejt në tri pyetjet, atyre që konsumojnë nga 10-20 cigare, atyre që konsumojnë ma teper se 20 cigare në ditë dhe atyre që nuk e konsumoj nuk ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit. Në pyetjen e të anketuarave “Konsumimi ditor i cigareve”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejt në tri pyetjet, atyre që konsumojnë nga 10-20 cigare, atyre që konsumojnë ma teper se 20 cigare në ditë dhe atyre që nuk e konsumoj ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 64% e femrave të anketuara nuk e konsumojnë duhanin. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket konsumimit të duhanit, femrat më pak e konsumojnë duhanin ( $\chi^2=6.386$ ;  $P<0.014$ ) (tabela 4).

**Tabela 5. Pyetësi: “Frekuenca e konsumimit të alkoholit. Konsumimi ditor”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.**

V. Konsumimi i alkoholit	36> M	36> F	$\Sigma$
rregullisht (çdo ditë)	2	6	8

kohë pas kohë (nganjëherë në javë)	38	17	55
nuk e konsumoj	10	27	37
$\Sigma$	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2=42.880$ df: 2 P= 0.000	$\chi^2=21.280$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2=13.240$ df: 2 P= 0.001

Frekuenca e konsumimit të alkoholit është e paraqitur në tabelën 5. Konsumimi ditor i alkoholit i tepruar do të ishte i damshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive. Në pyetjen e të anketuarëve “Konsumimi ditor i alkoholit”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejt në tri pyetjet, atyre që konsumojnë rregullisht alkohol, atyre që kohë pas kohë (nganjëherë në javë) dhe atyre që nuk e konsumoj dhe se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor brenda grupit. Në pyetjen e të anketuarave “Konsumimi ditor ialkoholit”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejtta në tri pyetjet, atyre rregullisht (çdo ditë) që pijnë alkohol, atyre që konsumojnë kohë pas kohë (nganjëherë në javë) dhe atyre që nuk e konsumoj ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 27 prej tyre ose 54% e femrave të anketuara nuk e konsumojnë alkoholin. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket konsumimit të alkoholit, femrat më pak e konsumojnë alkoholin ( $\chi^2=6.386$ ;  $P<0.014$ ).

***Tabela 6. Pyetëtori: “Shprehit në ushqim në shujta”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.***

VI. Shprehit në ushqim në shujta	36> M	36> F	$\Sigma$
1 here ne ditë	1	6	7
2 here ne ditë	24	21	45

3 here ne ditë	24	15	39
4 here ne ditë	1	8	9
$\Sigma$	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2=42.320$ df: 3 P= 0.000	$\chi^2=11.280$ df: 3 p= 0.010	$\chi^2=11.293$ df: 3 P= 0.001

Frekuenca e shprehis në ushqim në shujta është e paraqitur në tabelën 6. Konsumimi ditor i ushqimit shumë herë në ditë dhe vlera kalorike të mëdha do të ishte i damshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive, sepse do të kemi një mbipeshë te popullata që është ndër faktorët e rrezikshmeris për shumë sëmundje. Në pyetjen e të anketuarëve “Shprehit në ushqim në shujta”, të anketuarit e kësaj moshe kanë përgjigje të njejt në dy pyetjet, atyre që konsumojnë rregullisht 2 here ne ditë, dhe atyre që 3 here ne ditë dhe se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor brenda grupit sepse vetëm nga një i testuar janë përgjigjur 1 here ne ditë dhe 4 here ne ditë. Në pyetjen e të anketuarave “shprehit në ushqim në shujta”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejta në katër pyetjet, atyre që marrin ushqimin 1 here ne ditë, atyre që marrin 2 here ne ditë atyre që marrin 3 here ne ditë dhe atyre që marrin 4 here ne ditë ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 21 prej tyre ose 42% e femrave të anketuara marrin shujta 2 here ne ditë. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket shprehive në ushqim në shujta sepse femrat marrin 2 here ne ditë ( $\chi^2=11.293$ ;  $P<0.001$ ).

***Tabela 7. Pyetëtori: “Sa orë gjum bëni”, për të anketuarit e moshës mbi 36 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.***

VII. Sa orë gjumë bëni	36> M	36> F	$\Sigma$
5 orë	0	2	2
6 orë	1	7	8

7 orë	23	10	33
8 orë	20	18	38
9 orë	6	11	17
10 orë>	0	2	2
$\Sigma$	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2=65.92$ df: 5 P= 0.000	$\chi^2=11.280$ df: 5 p= 0.010	$\chi^2=15.197$ df: 5 P= 0.009

Frekuenca e e asaj se „Sa orë gjumë bëni „ është e paraqitur në tabelën 7. Njeriu ka nevojë për gjum sepse nevojat ditore janë 7-8 ore gjum.. Në pyetjen e të anketuarëve “Sa orë gjumë bëni”, të anketuarit e kësaj moshe përafersisht kanë përgjigje përafersisht të njëjt në dy përgjigje, atyre që bëjnë gjum 7 orë në ditë dhe atyre që bëjnë gjum 8 orë në ditë. 12% e të anketuarve bëjnë gjumë deri 9 orë. Në pyetjen “Sa orë gjumë bëni”, të anketuarat e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njëjta në gjashtëpërgjigje, atyre që bëjnë gjum 5 orë, atyre që bëjnë 6 orë gjum, atyre që bëjnë gjum 7 orë, atyre që bëjnë gjum 8 orë, atyre që bëjnë gjum 9 orë dhe atyre që bëjnë gjum mbi 10 orë, ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 18 prej tyre ose 36% e femrave të anketuarave bëjnë gjum 8 orë ne ditë. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket pyetjes e të anketuarëve për dy gjinit “Sa orë gjumë bëni”, sepse bëjnë gjum 8 orë ne ditë kurse meshkujt bëjnë gjum 7 orë në ditë ( $\chi^2=15.197$ ;  $P<0.009$ ).

### 5.1.2. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: Moshë: 31-35

**Tabela 8. Pyetëtori: “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.**

I – Merrem me aktivitete rekreative	31-35 M	31-35 F	$\Sigma$
-------------------------------------	---------	---------	----------

sportive			
regullisht (së paku 3 here në javë)	11	10	21
Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	21	16	37
Asnjë here	18	24	42
$\Sigma$	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2= 3.160$ df: 2 P= 0.206	$\chi^2= 5.920$ df: 2 p= 0.052	$\chi^2=1.580$ df: 2 P= 0.454

Aktivitetet rekreative sportive në këtë moshë kanë një rëndësi të veçantë për shëndetin e njeriut. Kjo periudh manifestohet me zvoglimin e aktiviteteve fizike dhe konsumimin e ushqimit të njëjt, çka krijohet një disproporcion në mes energjis së shfrytëzuar dhe kalorive të deponuara.

Në pyetjen e të anketuarëve “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, 42% nga të anketuarëve merren kohë pas kohe (kryesisht vikendeve) si dhe 36% asnjehere dhe 22% rregullisht, çka tregon se nuk ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që merren rregullisht dhe atyre që nuk merren asnjëherë. Në pyetjen e të anketuarave “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, në mes të anketuarave nuk ekziston një dallim i rëndësishëm. Gjithashtu nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje ( $\chi^2=1.580$ ;  $P<0.454$ ) (tabela 8).

***Tabela 9. Pyetëtori: “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme”, për të anketuarit e moshës 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.***

II – Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme:	<b>31-35 M</b>	<b>31-35 F</b>	$\Sigma$
---	----------------	----------------	----------

Po	35	15	50
Nuk jamë i sigurt	14	28	42
Jo	1	7	8
$\Sigma$	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2=35.320$ df: 2 P= 0.000	$\chi^2= 13.48$ df: 2 p= 0.001	$\chi^2=17.167$ df: 2 P= 0.000

Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në çdo qytet të Kosovës do të ishte i dobishëm në ruajtjen dhe avansimin e shëndetit për popullatën e e të gjitha moshave dhe gjinive, sidomos e asaj mbi moshën 30-35 vjeçare. Në pyetjen e të anketuarëve “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme”, 35 të anketuar ose 70% nga të anketuarëve përgjigjen se “se PO”, çka ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që mendojnë se: “Nuk jamë i sigurt” dhe atyre që janë përgjigjur “JO”. Te femrat 28% shprehen se “Nuk jamë i sigurt” dhe ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit në pyetjen: “Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë do të jetë i dobishme”. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje ( $\chi^2=17.167$ ;  $P<0.000$ ) (tabela 9). Fakti se të anketuarit e gjinisë mashkullore dhe femrore nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi rëndësin e organizimit të aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në Prishtinë. Kjo edhe reflektohet me pjesëmarrje shumë të vogël të popullatës së Prishtinës në aktivitete rekreative sportive sidomos e asja femrore.

***Tabela 10. Pyetësi: “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.***

III. Qëndrimi i të anketuarave mbi pjesëmarrjen aktive në aktivitetet rekreative sportive. Pjesëmarrja aktive në aktivitetet rekreative sportive	<b>31-35 M</b>	<b>31-35 F</b>	$\Sigma$
--	----------------	----------------	----------

Po	27	14	41
Nuk jamë i sigurt	20	26	46
Jo	3	10	13
$\Sigma$			100
$\chi^2$	$\chi^2=21.000$ df: 2 P= 0.000	$\chi^2= 8.320$ df: 2 p= 0.016	$\chi^2= 8.674$ df: 2 P= 0.013

Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative sportive në çdo qytet të Kosovës do të ishte i dobishëm në ruajtjen dhe avansimin e shëndetit për popullatën e të gjitha moshave dhe gjinive, sidomos e asaj mbi moshën 31-35 vjeçare. Në pyetjen e të anketuarëve “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”, 27 të anketuar ose 54% nga të anketuarëve përgjigjen se “PO”, 20 të anketuar ose 40% përgjigjen “Nuk jamë i sigurt” dhe 3 ose 6% përgjigjen se “JO”, çka ekziston një dallim i rëndësishëm në mes atyre që mendojnë se: Po – marr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive, atyre që mendojnë “Nuk jamë i sigurt” dhe atyre me përgjigje “Jo”. Te femrat ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit në pyetjen: “A merrni pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rekreative sportive”. Ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket kësaj pyetjeje ( $\chi^2=8.674$ ;  $P<0.013$ ) (tabela 10).

Qëndrimi i të anketuarëve të gjinisë mashkullore dhe femrore nuk është i njejt. . Kjo edhe reflektohet me pësëmarrje shumë të vogël të popullatës së Prishtinës në aktivitete rekreative sportive.

***Tabela 11. Pyetësori: “Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor”, për të anketuarit e moshës 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.***

IV. Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor	31-35 M	31-35 F	$\Sigma$
10-20 cigare	21	19	40

ma teper se 20 cigare në ditë	9	5	14
nuk e konsumoj	20	26	46
$\Sigma$	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2=5.320$ df: 2 P= 0.069	$\chi^2=13.720$ df: 2 p= 0.001	$\chi^2=2.025$ df: 2 P= 0.545

Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor i duhanit do të ishte i damshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive. Në pyetjen e të anketuarëve “Konsumimi ditor i cigareve”, të anketuarit e kësaj moshe kanë përgjigje gati të njëjt në tri pyetjet, atyre që konsumojnë nga 10-20 cigare, atyre që konsumojnë ma teper se 20 cigare në ditë dhe atyre që nuk e konsumoj nuk ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit. Në pyetjen e të anketuarave “Konsumimi ditor i cigareve”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njëjta në tri pyetjet, atyre që konsumojnë nga 10-20 cigare, atyre që konsumojnë ma teper se 20 cigare në ditë dhe atyre që nuk e konsumoj ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 52% e femrave të anketuara nuk e konsumojnë duhanin. Nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket konsumimit të duhanit. ( $\chi^2=2.025$ ;  $P<0.545$ ) (tabela 11).

***Tabela 12. Pyetëtori: “Frekuenca e konsumimit të alkoholit. Konsumimi ditor”, për të anketuarit e moshës 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.***

V. Konsumimi i alkoholit	31-35 M	31-35 F	$\Sigma$
rregullisht (çdo ditë)	6	5	11



kohë pas kohe (nganjëherë në javë)	19	20	39
nuk e konsumoj	25	25	50
$\Sigma$	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2=11.320$ df: 2 P= 0.003	$\chi^2=13.000$ df: 2 p= 0.001	$\chi^2=0.117$ df: 2 P= 0.990

Frekuenca e konsumimit të alkoholit është e paraqitur në tabelën 12. Konsumimi ditor i alkoholit i tepruar do të ishte i damshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive. Në pyetjen e të anketuarëve “Konsumimi ditor i alkoholit”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejt në tri pyetjet, atyre që konsumojnë rregullisht alkohol, atyre që kohë pas kohë (nganjëherë në javë) dhe atyre që nuk e konsumoj dhe se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor brenda grupit. Në pyetjen e të anketuarave “Konsumimi ditor ialkoholit”, të anketuarat e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejta në tri pyetjet, atyre rregullisht (çdo ditë) që pijnë alkohol, atyre që konsumojnë kohë pas kohë (nganjëherë në javë) dhe atyre që nuk e konsumoj ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 27 prej tyre ose 54% e femrave të anketuara nuk e konsumojnë alkoholin. Nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket konsumimit të alkoholit, ( $\chi^2=0.117$ ;  $P<0.099$ ).

***Tabela 13. Pyetësi: “Shprehit në ushqim në shujta”, për të anketuarit e moshës mbi 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.***

VI. Shprehit në ushqim në shujta	<b>31-35 M</b>	<b>31-35 F</b>	$\Sigma$
1 here ne ditë	8	3	11

2 here ne ditë	21	16	37
3 here ne ditë	16	24	40
4 here ne ditë	5	7	12
$\Sigma$	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2=12.880$ df: 3 P= 0.005	$\chi^2=11.200$ df: 3 p= 0.010	$\chi^2=4.882$ df: 3 P= 0.180

Frekuenca e shprehis në ushqim në shujta te moshë 31-35 vjeçare është e paraqitur në tabelën 13. Konsumimi ditor i ushqimit shumë herë në ditë dhe vlera kalorike të mëdha do të ishte i damshëm për shëndetin e popullatës e të gjitha moshave dhe gjinive, sepse do të kemi një mbipeshë te popullata që është ndër faktorët e rrezikshmeris për shumë sëmundje. Në pyetjen e të anketuarëve “Shprehit në ushqim në shujta”, të anketuarit e kësaj moshe janë përgjigjur 2 here ne ditë me 42%, dhe atyre 3 here ne ditë me 32% dhe se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor brenda grupit. Në pyetjen e të anketuarave “shprehit në ushqim në shujta”, të anketuarit e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejta në katër pyetjet, atyre që marrin ushqimin 1 here ne ditë, atyre që marrin 2 here ne ditë atyre që marrin 3 here ne ditë dhe atyre që marrin 4 here ne ditë ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit, sepse 24 prej tyre ose 48% e femrave të anketuara marrin shujta 3 here ne ditë. Nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket shprehive në ushqim në shujta ditore ( $\chi^2=4.882$ ;  $P<0.180$ ).

***Tabela 14. Pyetësi: “Sa orë gjum bëni”, për të anketuarit e moshës mbi 31-35 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.***

VII. Sa orë gjumë bëni	31-35 M	31-35 F	$\Sigma$
5 orë	1	1	2

6 orë	9	10	19
7 orë	10	13	23
8 orë	10	11	21
9 orë	15	13	28
10 orë>	5	2	7
$\Sigma$	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2=13.840$ df: 5 P= 0.016	$\chi^2=17.680$ df: 5 p= 0.003	$\chi^2=1.920$ df: 5 P= 0.860

Frekuenca e e asaj se „Sa orë gjumë bëni „, është e paraqitur në tabelën 14. Njeriu ka nevojë për gjum sepse nevojat ditore janë 7-8 ore gjum. Në pyetjen e të anketuarëve “Sa orë gjumë bëni”, të anketuarit e kësaj moshe përafersisht kanë përgjigje të njejt në dy përgjigjet, atyre që bëjnë gjum 7 orë në ditë dhe atyre që bëjnë gjum 8 orë në ditë. 30% e të anketuarve bëjnë gjumë deri 9 orë. Në pyetjen “Sa orë gjumë bëni”, të anketuarat e kësaj moshe nuk kanë përgjigje të njejt në gjashtë përgjegjje, atyre që bëjnë gjum 5 orë, atyre që bëjnë 6 orë gjum, atyre që bëjnë gjum 7 orë, atyre që bëjnë gjum 8 orë, atyre që bëjnë gjum 9 orë dhe atyre që bëjnë gjum mbi 10 orë, ekziston një dallim i rëndësishëm brenda grupit. Nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor në mes femrave dhe meshkujve sa i përket pyetjes e të anketuarëve për dy gjinit “Sa orë gjumë bëni”, sepse bëjnë gjum të njejt të shprehur në orë në ditë sepse ( $\chi^2=1.920$ ;  $P<0.860$ ).

### 5.1.3. PYETËSORI PËR STILIN E JETESËS: Moshë: 26-30

***Tabela 15. Pyetëtori: “Merrem me aktivitete rekreative sportive”, për të anketuarit e moshës 26-30 vjeçare të gjinisë mashkullore dhe femrore.***

I – Merrem me aktivitete rekreative sportive	26-30 M	26-30 F	Σ
regullisht (së paku 3 here në javë)	22	13	35
Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	16	29	45
Asnjë here	12	8	20
Σ	50	50	100
$\chi^2$	$\chi^2= 3.040$ df: 2 P= 0.218	$\chi^2= 14.440$ df: 2 p= 0.000	$\chi^2=6.870$ df: 2 P= 0.032

